

Në pajtim me nenin 55 paragrafi 1 i Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare" Gazeta e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 161/2019), Ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi plan-program të shkurtuar për lëndën Gjuhë angleze për klasën V të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21.

MINISTRIA PËR ARSIM DHE SHKENCË  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



**Plan-program i shkurtuar**

**GJUHË ANGLEZE**

**Për klasën e pestë (V) të arsimit fillor nëntëvjeçar**

**Shkup, 2020**

## 1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Gjuhë angleze bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën që zbatohet rregullisht në përputhje me plan-programin e përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara/fusha mësimore dhe njësi mësimore që duhet të realizohen gjatë 159 ditëve mësimore, me kohëzgjatje prej 30 minutash, me çka ruhet fondi i parashikuar javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, 3 orë në javë, respektivisht, 96 orë gjithsej.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, konceptet, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në plan-programin e rregullt mësimor.

## 2. Vështrim i temave<sup>1</sup>

**TEMA 1. BOTA IME E VOGËL: FAMILJA, SHTËPIA, SHOKËT (24 ORË)**

**TEMA 2. BOTA IME E JASHTME: SHKOLLA, INTERESAT, AKTIVITETET E LIRA (24 ORË)**

**TEMA 3. LAGJJA JONË, QYTETI YNË, BOTA JONË (24 ORË)**

**TEMA 4. PLANTI YNË, SHËNDETI YNË, ARDHMËRIA JONË (24 ORË)**

Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të orëve të ofruara nga plan-programi i shkurtuar, rekomandohet një qasje holistike për mësimin e gjuhës brenda temave të dhëna, e cila përfshin lloje të ndryshme oërshe që përfshijnë jo vetëm përvetësimin e njësive leksikore dhe strukturave gramatikore, por edhe funksionet e parashikuara të gjuhës, që në mënyrë reciproke do të kontribuojnë në përvetësimin efektiv të aftësive gjuhësore (të dëgjuarit dhe leximit me të kuptuarit, të folurit dhe të shkruarit) dhe do të mundësojë zhvillimin e plotë të aftësive komunikuese të nxënësit.

Në këtë mënyrë, rekomandohet një prezantim cilësor i përmbajtjes së re mësimore me zbatimin e aktiviteteve të parashikuara për zbatimin e tyre.

---

<sup>1</sup> Во однос на дадените теми и понудениот број на часови за истите, наставникот/наставничката прави проценка за начинот и обемот при обработката на секоја тема поединечно, притоа земајќи го предвид интегрираниот и избалансираниот пристап при изучување на сите јазични елементи, согласно можности на учениците и нивните потреби.

Multikulturalizmi, përmbajtjet ndërkulturore dhe shkrim-leximi mediatik janë një pjesë përbërëse e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj dhe prania e tyre në shumicën e përmbajtjeve mësimore mundëson realizimin konkret të tyre dhe zbatimin praktik të njohurive dhe aftësive të fituara në mënyrën moderne të komunikimit dhe stilit të jetesës.

### 3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja për realizimin e \programit të shkurtuar për lëndën e gjuhës angleze është programi mësimor i rregullt (rezultatet e të nxënit, përmbajtja dhe konceptet, aktivitetet e propozuara dhe metodat dhe standardet e vlerësimit).

Gjatë realizimit të programit mësimor të shkurtuar, mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj realizohet përmes një qasjeje të integruar pa veçuar komponentë dhe shkathtësi të veçanta gjuhësore në lidhje me numrin e orëve të planifikuara. Është e rëndësishme të theksohet se mësimi i anglishtes nuk bazohet në një studim specifik të elementeve të dhëna të gjuhës, të tilla si fjalori, gramatika dhe funksionet gjuhësore, por kërkon një studim të ekuilibruar dhe të integruar të këtyre elementeve në kontekst. Gramatika në veçanti nuk duhet të studiohet duke mbajtur mend rregulla dhe përkufizime të përdorimit, por në kontekst (me shembuj), për të kuptuar thelbin dhe zbatimin autentik të gjuhës.

Qëllimet e programit mësimor për klasën e pestë janë pjesë e qëllimeve të parashikuara në ciklin e dytë të zhvillimit për mësimin e një gjuhe të huaj (klasa IV - VI) në të cilin nxënësit pritet të arrijnë nivelin përgatitor A1 për aftësinë e gjuhës duke përparuar nga klasa në klasë duke rritur gradualisht numrin e artikujve leksikorë, llojin e funksioneve gjuhësore dhe kompleksitetin e strukturave gramatikore. Kjo do të thotë që vëmendje e njëjtë u kushtohet aftësive gjuhësore në nivel receptiv dhe produktiv, siç janë: të kuptuarit e të dëgjuarit, të kuptuarit e të lexuarit, të folurit (ndërveprimi i fjalës dhe prodhimi) dhe të shkruarit (ndërveprimi me shkrim dhe prodhimi me shkrim), në mënyrë që të inkurajohet zhvillimi i integruar i kompetencës komunikuese.

Mësimi në gjuhën angleze për nxënësit e kësaj moshe bazohet në të mësuarit shumë-shqisor (vizual, dëgjimor, prekës, etj.) dhe të mësuarit gjithëpërfshirës që mbulon aspektet njohëse, afektive dhe motorike të nxënësve, d.m.th mësimdhënësi do të integrojë komponentët e ndryshëm që do ta bëjnë gjuhën të mësohet në një mënyrë funksionale.

Gjatë përzgjedhjes së aktiviteteve, duhet të merret parasysh diferencimi dhe shumëllojshmëria e të njëjtave, dhe duhet të zgjidhen aktivitete që janë të përshtatshme për moshën përkatëse të nxënësve, si dhe për zhvillimin e tyre njohës, d.m.th. aktivitete që do të tërheqin vëmendjen e nxënësve.

#### **4. Normativi për kuadrin arsimor**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në pajtim me normativin për kuadrin arsimor të dhënë në plan-programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën e Gjuhës angleze për klasën e pestë të shkollimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e konfirmoi:

Ministri për arsim dhe shkencë

---

Mila Carovska